



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:209407

Datë: 06.03.2023

Numri i dokumentit: 04045258

Ac.nr.6811/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Besnik Feka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.D. nga P., të cilin me autorizim e përfaqëson avokati B. P. nga P., kundër të paditurve M. M. nga fshati S.Komuna e P., të cilin me autorizim e përfaqëson avokati N. G. nga L.; S. P., të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Xh. M. nga P. dhe Komuna e G., të cilën me autorizim e përfaqëson avokati N. Sh. nga G., me objekt të kontestit fshirjen e regjistrimit nga regjistri i të drejtave në pronën e paluajtshme dhe rikthimin në gjendje të mëparshme, duke vendosur sipas ankesës së paditësit dhe të paditurit të parë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega Graçanicë C.nr.101/21 të datës 20.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 06.03.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

**APROVOHEN** si të bazuara ankesat e paditësit Sh. D. nga P. dhe e të paditurit M.M. nga fshati Saradran Komuna e Prizrenit, **PRISHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega në Graçanicë C.nr.101/21, i datës 20.04.2022 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e atakuar C.nr.101/21, të datës 20.04.2022, në pikën I të dispozitivit ka hedhur poshtë padinë e paditësit dhe ka anuluar të gjitha veprimet procedurale. Në pikët II të dispozitivit shpallet jo kompetentë për të vepruar sipas padisë së paditësit, kundër të paditurve, ndërsa në dispozitivin e III ka detyruar paditësin që bashkërisht t'ua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore si në vijim: i padituri i parë M.M. shumën prej 5,411.25 Euro; i padituri i dytë 3,611.25 Euro dhe i padituri i tretë shumën prej 3,786.75 Euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij Aktvendimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij Aktvendimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, me prozim si në të njëjtën.

Po ashtu i padituri i parë ka pashtuar ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimoe, sa i përket llogaritjes së shpenzimeve të procedurës kontestimore, me propozim si në të njëjtën.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

**-Ankesat e paditësit dhe e të paditurit të parë janë të bazuara.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi fillimisht ka ushtruar padi në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurve M. M.; S. P.; Komuna e Lipjanit dhe Komuna e Graçanicës, përmes së cilës ka kërkuar që të vërtetohet se është i pavlefshëm regjistrimi në regjistrat e paluajtshmërive në emër të të paditurit M. M., i bërë në ngastrën kadastrale 383/3 dhe 1051 ZK S., i regjistruar nga e paditura Komuna e G. me datë 25.07.2011 sipas certifikatës UL-73409082-00774 ZK S.. Andaj detyrohet Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Lipjanit që menjëherë pas pranimit të këtij Aktgjykimi të kthej në gjendje të mëparshme në hartat gjeodezike të ZK S.për parcelën kadastrale 1051 dhe 383/3 si dhe të paditurit të detyrohen që solidarisht, paditësit t'ia shpërblejnë shpenzimet e procedurës kontestimore. Me parashtresën e datës 25.03.2022 paditësi ka ndryshuar padinë, ndaj të paditurve M. M.; S. P. dhe Komuna e G., duke kërkuar tani ndaj tyre vërtetimin e të drejtës së pronësisë në parcelën me numër 1051 ZK Suhadollë.

Duke vepruar sipas padisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancave gjyqësore, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash, theksoi se duke vepruar në bazë të udhëzimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit, zhvilloi disa seanca gjyqësore dhe detyroi avokatin e paditësit për precizimin e kërkesëpadisë, për të përcaktuar se ky kontest a bjen në juridiksionin e gjykatës në kuptim të nenit 18.2 të LPK-ës. Avokati i paditësit në seancën e datës 20.04.2022 ka tërhequr padinë në lidhje me të paditurën Komuna e Lipjanit dhe ka mbetur pranë pretendimeve nga parashtresa e datës 25.03.2022 për vërtetimin e të drejtës së pronësisë. *(Për më shumë shih arsyetimin e Aktvebdimit të atakuar).*

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit nuk mund t'i pranojë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore nga pika 182.2, pika (n) i LPK-së, meqë ka të meta që nuk mund të ekzaminohen, dispozitivi dhe arsyetimi i aktvendimit nuk janë në harmoninë e duhur logjike dhe juridike, ndërsa faktet vendimtare nuk janë vërtetuar dhe arsyetuar si duhet, për çka edhe është bërë dhe vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike dhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së parë nuk e ka identifikuar objektin e kontestit ndërmjet palëve ndërgjyqëse, si rezultat i mungesës së vendosjes nga gjykata e shkallës së parë për ndryshimin e padisë së paditësit të bërë përmes parashtresës së datës 25.03.2022, se të njëjtën e lejon apo jo, bazuar në nenin 258 të LPK-ës. Paditësi përmes padisë fillestare kërkon nga të paditurit fshirjen

e regjistrimit nga regjistri i të drejtave në pronën e paluajtshme dhe rikthimin në gjendje të mëparshme, ndërsa me atë të ndryshuar me datë 25.03.2022, kërkon vërtetimin e të drejtës së pronësisë. Pra gjykata e shkallës së parë duke mos vendosur lidhur me ndryshimin e padisë së paditësit se të njëjtën e lejon apo jo, ka dështuar të identifikoj çështjen kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Ashtu siq është formuluar dispozitivi i Aktvendimit të atakuar nuk mund të dihet se për cilën çështje kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse është hedhur poshtë padia e paditësit, ndaj të paditurve.

Nga gjitha arsyet e cekuara si më lartë, Gjykata e Apelit gjeti se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkeljet e sipërcituara të cilat gjykata e shkallës së parë duhet t'i eliminojë në ri procedurë, në atë mënyrë që të ndërmer veprime përmes të cilave do t'i eliminoj shkeljet e cekura si më lartë, por njëkohësisht duke u kujdesur edhe për çështjet e tjera nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor dhe në këtë kuptim duhet të vlerësoj të gjitha prezumimet procedurale që kanë të bëjnë me gjykatën, palët-përfaqësimin, objektin e shqyrtimit dhe rregullsitë formale të padisë të vendos për themelësinë e saj. Me rastin e vendosjes në lidhje me kërkesën e paditësit, gjykata e shkallës së parë, përveçse ka për detyrim që të vërtetoj drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike në këtë procedurë, ajo duhet të kujdeset për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale.

Andaj, udhëzohet gjykata e shkallës së parë, që në ri procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, t'i eliminojë shkeljet e sipër theksuara, në atë mënyrë që konform dispozitave përkatëse të LPK-së (nenit 102) të kërkojë rregullimin e padisë, përkatësisht petivitumit të saj, në mënyrë që të përcaktohet qartë objekti i shqyrtimit, numri i parcelës, sipërfaqja e saj me përmasa dhe kufij, të kërkoj sqarime nga eksperti gjeodet apo të konsideron nxjerrjen edhe njëherë të kësaj prove me angazhimin e ekspertit tjetër gjeodet dhe të del në vendin ku gjindet prona e paluajtshme me propozimin e palëve apo sipas detyrës zyrtare, bazuar në nenin 319, 320 dhe 326 të LPK-ës, pastaj përmes provave konkrete materiale të dorëzuara nga palët ndërgjyqëse fillimisht të evidentojë, përkatësisht të vërtetojë faktet vendimtare dhe të nxjerrë një vendim të drejtë. Nëse paditësi mbetet pranë kërkesës fillestare për fshirjen e regjistrimit nga regjistri i të drejtave në pronën e paluajtshme dhe rikthimin në gjendje të mëparshme, të vlerësoj kompetencën e saj lëndore, ndërsa në qoftëse mbetet pranë kërkesës për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, të vërtetoi faktin se paditësi këtë të dejtë a e ka të regjistruar në regjistrat kadastral dhe nëse e ka, të vlerësoj interesin juridik për padi vërtetimi të parashtruar nga paditësi, konform nenit 391 pika e) të LPK-ës. Për shkak të ekonomizimit të procedurës kontestimore në fund, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që me rastin shqyrtimit në riprocedurë të kësaj lënde me një vendim gjyqësor të vendos për të gjitha kërkesat kryesore dhe ato aksesore (përfshirë këtu edhe për shpenzimet e procedurës) që mund ti kenë palët ndërgjyqëse dhe gjatë përpilimit të vendimit t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozitat e nenit 160 të LPK-së, ashtu që pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, të vërtetojë gjendjen faktike, bazën juridike të propozimit, duke zbatuar me saktësi të drejtën materiale.

Nga të cekurat më lartë e duke u mbështetur në dispozitën e neneve 194 dhe 195 paragrafi 1 pika c), të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2019:209407  
Datë: 06.03.2023  
Numri i dokumentit: 04045258

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6811/22, datë 06.03.2023

Kryetari i kolegjit,  
Ardian Ajvazi